

VENDIM
I ASAMBLESE SE PERGJITHSHME TE ORTAKEVE TE SHOQERISE
"BLUEPOINT PETROLEUM" Sh.P.K.

Sot, me date 30/6/2013, ora 10:00, ne seline e Shoqerise "BluePoint Petroleum" Sh.P.K., shoqeri tregtare me pergjegjesi te kufizuar, e themeluar e qe funksionon ne perputhje me legjislacionin shqiptar, e regjistruar ne Regjistrin Tregtar ne baze te Vendimit te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Tirane Nr. 22438, date 15.12.1999, me NUIS/NIPT K01318005N, me seli ne adresen Rruga "Medar Shtylla", Nr. 6/442, Pallati 5, Ap. 32, Tirane, u mbajt mbledhja e Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve, ne te cilen ish-in te pranishem ortaket qe zoterojne 100% (njqind perqind) te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise si me poshte vijon:

- **Z. Laert Duraj**, zoterues i 40% te kuotave te kapitalit themeltar te Shoqerise, i pranishem personalisht.
- **"A & M" Sh.P.K.**, zoteruese e 60% te kuotave te kapitalit themeltar te shoqerise, e perfaqesuar rregullisht nga Perfaqesuesi i saj Ligjor Z. Elidon Malaj.

Duke qene se jane te pranishem ortaket qe zoterojne te gjitha kuotat e kapitalit me te drejte vote, ne perputhje me Nenin 83/2 te Ligjit 9901/2008, te ndryshuar, ortaket shprehen dakord per te proceduar ne miratimin e vendimeve te vlefshme, pavaresisht se mungon nje akt formal thirrjeje per mbledhjen ne fjale.

Ortaket, pasi diskutuan ne lidhje me ceshtjet e veprimtarise se Shoqerise, dhe pasi degjuan shpjegimet e Administratorit dhe shqyrtuan Raportin mbi zvogelimin e kapitalit te shoqerise te pergatitur nga eksperti Julian Naqellari, i emeruar me vendimin e asamblese se ortakeve te shoqerise date 31 maj 2012, unanimisht

VENDOSEN:

1. Te miratojne Raportin e Zvogelimit te Kapitalit te Shoqerise BluePoint Petroleum shpk date 19 qershor 2013 te ekspertit kontabel Julian Naqellari bashkelidhur ketij Vendimi.
2. Te miratojne zvogelimin e kapitalit te shoqerise si pasoje e:
 - humbjeve te mbartura ne masen -- 246,191,059 leke
 - humbjes se vitit 2012 ne masen -- 140,216,393 leke.Kapitali i shoqerise pas zvogelimit te jete 428,663,000 leke, i ndare ne 4, 286,630 pjese me vlere nominale 100 leke dhe i ndare:
 - Ortaku Shoqeria A & M shpk zoteron 60% te pjeseve ose 2,571,978 pjese me vlere nominale 100 leke dhe
 - Ortaku Laert Duraj zoteron 40% te pjeseve ose 1,714,652 pjese me vlere nominale 100 leke.
3. Te autorizojne Administratorin e Shoqerise per kryerjen e veprimeve te nevojshme prane Qendres Kombetare te Regjistrimit ne lidhje me depozitimin e ketij vendimi dhe regjistrimin e zvogelimit te kapitalit.

ASAMBLEJA E ORTAKEVE

Laert DURAJ




"A & M" Sh.P.K.
Perfaqesuar nga Administratori

Elidon MALAJ

